



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 7 prot.

Kamëz, më 22 .01. 2024

V E N D I M

Nr 07 Datë 22 / 01 / 2024

M B I

“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE GJATË VITIT 2024 PËR FAMILJET QË NUK JANË PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT, TË CILAT DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE”.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.01.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.04 Datë 11.01.2024 në mbështetje të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "për vetëqeverisjen vendore"; ligjit nr.57 dt. 18/07/2019 "Për asitencën sociale në Republikën e Shqipërisë neni 21, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.597 dt. 04/09/2019 kreu 4 pika 3, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, Vendimit nr.617 datë 22.09.2022 për disa ndryshime në Vendimin 597/2019, Vendimit nr.868 datë 29.12.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nt.597/2019 "për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1- Miratimin e kriterëve për dhënie të ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit të cilat do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike", si më poshtë vijon;

- Familjet të cilat jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme, në banesa të papërshtatshme, (objekte të modifikuara për banim si ish-stallat, magazinat etj.) dhe pa të ardhura.
- Familjet që janë të varfëra, të cilat kanë fëmijë nën 16 vjeç në përbërjen e tyre familjare dhe nuk kanë anëtarë madhorë në punë.
- Gra kryefamiljare, të cilat mund të jenë të ve-ja, të divorcuara ose në proces divorci me të ardhura të pamjaftueshme për jetesë.
- Familjet që kanë në përbërjen e tyre fëmijë të mitur në konflikt me ligjin, probleme dhune në familje, kryefamiljarë që vuajnë dënimin me heqje lirie, të cilat janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe të ardhura të pamjaftueshme.
- Familjet që kanë probleme të mëdha shëndetësore apo fatkeqësi njerëzore në familje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- Familje me dy anëtarë të moshuar, apo të vetmuar pa të ardhura të mjaftueshme për jetesë.
- Familje me anëtare mbi moshë aktive për punë, por që nuk janë përfitues nga skema e sigurimeve shoqerore për pension pleqërie dhe nuk kanë anëtare të tjerë në familje për orientim drejt tregut të punës.
- Familje me anëtare defakto të paaftë për punë, por që ligjërisht nuk janë përfitues nga skema e PAK , anëtarë të familjes që kane krijuar varësi nga alkooli ,droga etj

Kohëzgjatja e qendrimit në skemë do të jetë e limituar në kohë dhe e kushtëzuar me vlerësimin social-ekonomik për ndryshimin e kushteve të jetesës.

2- Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

